

**MBI AKTIVITETIN  
E KOMISIONIT TË POSAÇËM  
PARLAMENTAR  
DHE ZHVILLIMET NË REFORMËN  
PËR MIRËQEVERISJEN, ANTIKORRUPSIONIN  
DHE SUNDIMIN E LIGJIT**



**KPP – Buletin periodik 06  
Nëntor 2024**



**KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR  
“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,  
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN  
PËR SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**

## Gjetjet e analizës paraprake, ekspertët e Komisionit të Posaçëm nisin tryezat tematike

Pas vlerësimit dhe analizës paraprake të situatës aktuale në fushën e *mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit* Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe anëtarët e Sekretariatit Teknik të angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm nisën fazën e konsultimit publik të draftit të parë të Dokumentit Analitik.

Ekspertët që punuan për *shtyllën e antikorrupsionit* zhvilluan gjithashtu një takim me ekspertët ndërkombëtarë të caktuar nga Ambasada e SHBA-ve në Tiranë dhe Delegacioni i Bashkimi Europian, pjesë e projekteve të asistencës, me qëllim prezantimin e gjetjeve paraprake të analizës lidhur me korrupsionin politik, sektorët me risk më të lartë ndaj korrupsionit, forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe abuzimeve, menaxhimin e financave publike, parandalimin e pastrimit të parave dhe ndërtimin e një shoqërie me integritet.

Gjatë muajit nëntor 2024 u zhvilluan 9 tryeza publike tematike, të cilat u përqendruan në gjetjet dhe tezat për diskutim me publikun dhe synonin gjithëpërfshirjen dhe transparencën e procesit. Prezantimet e ekspertëve kishin një minutazh të limituar prej jo më shumë se 10–12 minuta secili, duke u lënë hapësirën e nevojshme komenteve, sugjerimeve dhe diskutimeve të pranishmëve në sallë.

Në tryezat publike të moderuara nga ekspertët morën pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore, të agjencive ligjzbatuese, të institucioneve të pavarura, të shoqërisë civile, të universiteteve publike e jopublike, të medias, të komunitetit të biznesit, të dhomave të tregtisë dhe të institucionet financiare, anëtarë të Komisionit të Posaçëm etj. Të pranishëm ishin edhe ekspertë dhe përfaqësues të huaj të atashuar pranë Komisionit nga Delegacioni i BE-së, Ambasada e SHBA-ve në Tiranë, Prezenca e OSBE-së, ODPDAT-i, UNDP-ja, Zyra e Këshillit të Europës, Ambasada Franceze, Ambasada Britanike, Ambasada Zvicerane etj.

Gjatë diskutimeve të pranishmit bënë komente dhe sugjerime konkrete, të cilat do të ndihmojnë në pasurimin e draftit final të Dokumentit Analitik mbi situatën aktuale në fushën e mirëqeverisjes, antikorrupsionit e të sundimit të ligjit dhe të Planit Kombëtar të Veprimit.

# TRYEZA PUBLIKE TË PËRBASHKËTA

4 nëntor 2024

## Tryeza me temë “Integriteti i administratës publike dhe ofrimi i shërbimeve”, organizuar në kuadër të shtyllës së mirëqeverisjes dhe shtyllës së antikorrupsionit

Paneli i parë i kësaj tryeze, me temë “*Integriteti i administratës publike*”, që u moderua nga z. Adrian Haçkaj, drejtor i Kërkimeve në Institutin për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI), kishte në fokus prezantimin e gjetjeve kryesore për etikën dhe integritetin në administratën publike, me qëllim parandalimin e korrupsionit dhe luftën kundër tij, si dhe shërbimet digjitale të ofruara prej saj. Gjetjet kryesore u prezantuan nga z. Geron Kamberi, përfaqësues i Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG), dhe znj. Iris Aliaj, përfaqësuese e Qendrës për Drejtësi Gjinore, që theksuan se analiza e situatës së etikës dhe integritetit të administratës publike merr një vlerë të veçantë në kushtet kur nevojitet një administratë në standardet europiane dhe e përkushtuar në shërbimin ndaj qytetarëve.

Lidhur me çështjen ekspertët konstatuan mungesën e një zinxhiri të qartë hapash, procedurash dhe afatesh kohore kur ka raste të shkeljes së Kodit të Etikës dhe të integritetit nga zyrtarët dhe nëpunësit publikë, ose në rastet kur denoncohen nga qytetarë, nga media dhe grupe interesi. Ata sugjeruan rishikimin e kuadrit ligjor për rregullat e etikës në administratën publike, për konfliktin e interesin, krijimin e një kulture tjetër dhe masa shtesë për rrjetin e sinjalizuesve dhe mbrojtjes së sinjalizuesve etj. Sipas ekspertëve, nevojitet plotësimi dhe rishikimi i kuadrit rregullator për veprimtarinë e administratës qendrore e vendore dhe konfliktin e interesit në përputhje me standardet e BE-së, krijimin e një regjistri për shkeljet e evidentuara nga nëpunësit publikë etj.

Paneli i dytë, me temë “*Ofrimi i shërbimeve digjitale*”, u drejtua nga prof. dr. Migena Leskoviku, Instituti i Studimeve Europiane (ISE), Universiteti i Tiranës. Lidhur me çështjen ekspertët vlerësuan se mbetet një hendek në përgatitjen e plotë të administratës për të përdorur teknologjinë e re dhe rekomanduan disa zgjidhje dhe drejtimet ku mund të ndërhyhet.

Sugjerimet e ekspertëve kanë të bëjnë me konsolidimin e kuadrit ligjor për shërbimet digjitale, sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave, harmonizimin e plotë të legjislacionit me atë BE-së, garantimin e aksesit të barabartë në shërbimet digjitale dhe trajtimin e barabartë të të gjithëve, rritjen e aksesit në shërbimet digjitale në tërësi e veçanërisht në zonat rurale, zgjerimin e ndërveprimit mes institucioneve publike dhe sektorit privat, rritjen e investimeve në infrastrukturën digjitale dhe forcimin e kapaciteteve administrative, rritjen e ndërgjegjësimit për shërbimet *on-line* dhe edukimi digjital etj.

11 nëntor 2024

## **Tryeza me temë “Forcimi i kuadrit ligjor e institucional për parandalimin dhe luftën kundër abuzimit me financat publike dhe transparencë në menaxhimin e tyre”, organizuar në kuadër të shtyllës së mirëqeverisjes dhe shtyllës së antikorrupsionit**

Kjo tryezë, e cila u moderua nga prof. asoc. dr. Mirela Miti, kishte si qëllim kryesor të analizonte gjetjet dhe problematikat lidhur me transparencën në menaxhimin e financave publike dhe parandalimin e korrupsionit në këtë fushë. Në panelin e parë avokati Ened Topi, ekspert nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë në Tiranë, prezantoi gjetjet kryesore dhe drejtimet për ndërhyrje të evidentuara nga grupi i ekspertëve të shtyllës së antikorrupsionit për forcimin e eficiencës së institucioneve me përgjegjësi në luftimin e korrupsionit dhe monitorimin e financave publike. Duke vlerësuar se legjislacioni për auditimin e brendshëm është në përputhje me standardet ndërkombëtare, ekspertët sugjerojnë se nevojitet që kuadri rregullator lidhur me të të adresojë boshllëqet e mbetura legjislative. Ekspertët sugjeruan gjithashtu krijimin e Bordit të Kontrollit dhe Auditimit të Brendshëm Financiar Publik (duke bashkuar kontrollin dhe auditimin), si një strukturë e pavarur me mandat të mirëpërcaktuar nga Kuvendi.

Në panelin e dytë u bë prezantimi i gjetjeve kryesore të analizës lidhur me efektivitetin dhe transparencën në menaxhimin e financave publike nga prof. asoc. dr. Olta Milova, Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit të Tiranës. Ekspertët vlerësuan se duhen bërë përmirësime në të gjithë komponentet e menaxhimit të financave publike, si dhe të rritet roli mbikëqyrës i Kuvendit për buxhetin e shtetit dhe financat publike. Gjithashtu u propozua krijimi i Këshillit Fiskal, si një organ i pavarur mbikëqyrës me mandat për të vlerësuar rreziqet fiskale dhe monitoruar pajtueshmërinë me rregullat fiskale, për vlerësimin e pavarur të politikës fiskale, rritjen e rolit të shoqërisë civile etj. Ekspertët thanë gjithashtu se Shqipëria duhet të përmirësojë menaxhimin e investimeve publike dhe e vunë theksin në një sërë ndërhyrjesh të nevojshme në këtë fushë.

27 nëntor 2024

## **Tryeza me temë “Garantimi i së drejtës së pronës dhe lufta kundër korrupsionit në sektorin e pronave”, organizuar në kuadër të shtyllës së sundimit të ligjit dhe shtyllës së antikorrupsionit**

Në këtë tryezë, e cila u moderua nga prof. asoc. dr. Nadia Rusi, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, u diskutuan gjetjet dhe sugjerimet e ekspertëve lidhur me problematikat dhe sfidat që has çështja e pronave në Shqipëri, garantimi i së drejtës së pronës, si dhe u propozuan një

sërë masash konkrete për forcimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në sektorin e pronave. I pranishëm në këtë tryezë ishte edhe Kryeministri, z. Edi Rama.

Prezantimi i gjetjeve kryesore të analizës së ekspertëve lidhur me garantimin e së drejtës së pronës u bë nga znj. Rusi, e cila bëri një panoramë të plotë të situatës aktuale të së drejtës së pronës dhe përpjekjet e bëra nëpërmjet një agjende reformash, që synojnë përmirësimin e kuadrit ligjor dhe administrativ të pronësisë për problematikat e hasura.

Prof. dr. Nada Dollani, nga qendra “ALTRI” një prezantim të punës së ekspertëve për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në sektorin e pronave. Duke iu referuar raporteve të Komisionit European për Shqipërinë, përfshirë edhe raportin e fundit, të vitit 2024, si dhe raportet e aktorëve të tjerë ndërkombëtarë, ekspertët vlerësuan se janë ndërmarrë disa hapa pozitivë në luftën kundër korrupsionit, siç është digjitalizimi i proceseve dhe shërbimeve, megjithatë theksuan se pronat vijojnë të konsiderohen një sektor me risk të lartë korrupsioni.

Kryeministri Rama vlerësoi punën e bërë nga ekspertët e pavarur të atashuar pranë Komisionit dhe theksoi se Kuvendi duhet të shndërrohet në qendrën kryesore të bashkëpunimit për përmbushjen e standardeve të BE-së. Kryeministri nënvizoi se Komisioni i Posaçëm për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit është një instrument i pazëvendësueshëm dhe i patjetërsueshëm për suksesin e vendit në procesin e anëtarësimit, që do të shërbejë për koordinimin e institucioneve që përfaqësojnë tri pushtetet dhe garantimin e llogaridhënies në përmbushjen e detyrimeve në procesin e integritetit. “Nëse ne i zbatojmë si duhet këto detyra, ky shtet do të jetë një shtet me standardet e BE-së. E mira e këtij procesi është se ne nuk do të çojmë Shqipërinë në Bruksel, por do të futim Europën në Shqipëri në të gjitha gjymtyrët e shtetit dhe të shoqërisë, duke garantuar lirinë individuale në të gjitha aspektet, sundimin e ligjit në të gjitha aspektet dhe do të garantojmë procesin demokratik në të gjitha aspektet. Këto janë tri gjëra që nuk i bën dot askush për ty. Vetëm në këtë proces mund të bëhen në kohë”, – u shpreh z. Rama.

Gjatë diskutimeve të tryezës, përfaqësues të botës akademike, shoqërisë civile, organizatave të biznesit, institucioneve shtetërore dhe agjencive ligjzbatuese shprehën ide dhe bënë propozime konkrete për përmirësimin e draftit të Dokumentit Analitik, si për shembull: nevoja për rritjen e kapaciteteve profesionale të administratës së ASHK-së, unifikimi i procedurave dhe monitorimi i zbatimit të vendimeve gjyqësore, ngritja e platformave automatike të proceseve të brendshme për të rritur transparencën ndaj qytetareve, krijimi i sistemeve të vlerësimit të riskut për burimet njerëzore të agjencive të titujve të pronësisë, regjistrimi fillestar, planet e integritetit etj.

## TRYEZA PUBLIKE INDIVIDUALE SIPAS SHTYLLAVE

5 nëntor 2024

### Tryeza me temë “Parandalimi i korrupsionit në sektorin privat dhe ndërtimi i një shoqërie me integritet”, organizuar në kuadër të shtyllës së antikorrupsionit

Në këtë tryezë, e cila u moderua nga dr. Ilda Muçmataj, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, ekspertët prezantuan gjetjet kryesore të analizës së tyre të deritanishme dhe shprehën disa mendime lidhur me masat ligjore dhe mekanizmat institucionalë për të nxitur dhe mbështetur qytetarët dhe aktorët e shoqërisë civile që të denoncojnë korrupsionin si dhe për mbrojtjen e denoncuesve.

Në panelin e parë, me temë “*Parandalimi i korrupsionit përmes forcimit të integritetit në sektorin privat*”, progresi, problematikat dhe masat e nevojshme që duhen marrë për parandalimin e korrupsionit u prezantuan nga prof. asoc. dr. Jonida Rystemaj dhe Ll. M. Monika Cano, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

Gjetjet e ekspertëve lidhur me përpjekjet për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në sektorin privat konsistojnë në parandalimin e korrupsionit përmes masave në sektorin privat në tërësi, përfshirë tregjet me efekt të ndjeshëm në ekonomi. Për ekspertët mbetet ende sfida mbikëqyrja dhe monitorimi i ndërmarrjeve shtetërore, ndërsa mungesa e një regjistri të plotë publik për këto ndërmarrje dhe mungesa e auditimeve të jashtme të rregullta janë çështje që kërkojnë trajtim.

Në panelin e dytë, me temë “*Ndërtimi i një shoqërie me integritet*”, gjetjet kryesore u prezantuan nga dr. Sofjana Veliu, pedagoge në Universitetin Europian të Tiranës, dhe znj. Ardita Seknaj, përfaqësuese e Dhomës Ndërkombëtare Tregtare në Shqipëri. Ekspertët evidentuan si problematikë zbatimin e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, zhvillimet në institucionet kundër korrupsionit, bashkëpunimin me shoqërinë civile si dhe mbivendosjen e kompetencave mes strukturave dhe institucioneve të krijuara kundër korrupsionit. Ekspertët propozuan një sërë masash për ndërhyrje, si: bërja efektive e mekanizmit të sinjalizimit, rritja e rolit të shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit dhe në mbikëqyrjen e financave publike, futja e edukimit kundër korrupsionit në kurrikulat shkollore, krijimi i qendrave kërkimore për çështje të qeverisjes së mirë etj.

12 nëntor 2024

## Tryeza me temë “Parandalimi i korrupsionit politik – Integriteti i të zgjedhurve dhe drejtuesve të nivelit të lartë dhe parandalimi i hapësirave të legjislacionit për korrupsion/lobim”, organizuar në kuadër të shtyllës së antikorrupsionit

Në këtë tryezë, që u moderua nga z. Arian Dyrmishi, drejtor ekzekutiv i Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, prof. asoc. dr. Enkeleda Olldashi, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë, dhe znj. Erisa Proko, drejtore ekzekutive e Institutit për Zhvillim Strategjik, prezantuan gjetjet kryesore të analizës paraprake lidhur me integritetin e të zgjedhurve dhe drejtuesve të nivelit të lartë, financimin e fushatave zgjedhore, korrupsionin transnacional dhe parandalimin e korrupsionit në procesin legjislativ dhe parashtruan dhe disa sugjerime për ndërhyrjet që duhen bërë në legjislacion lidhur me masat ligjore dhe mekanizmat institucionalë për rritjen e transparencës dhe parandalimin e korrupsionit në procesin legjislativ.

Bazuar edhe në gjetjet, problematikat dhe rekomandimet e raporteve të Komisionit Europian dhe të GRECO-s, ekspertët theksuan nevojën e përcaktimit të rregullave të qarta për sanksionet në rastet e konfliktit të interesave, të kontakteve me lobistët ose veprimtari të tjera të ndaluara për deputetët, krijimin e një platforme publike, me qëllim që çdo kontakt dhe çdo propozim i bërë nga lobistët të bëhet publik e të mund të ndiqet nga qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile, si dhe nevojën e vendosjes së një mekanizmi mbikëqyrjeje të pavarur. Ekspertët sugjeruan krijimin e një mekanizmi të pavarur për mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit të Sjelljes dhe raportimin e shkeljeve, i cili mund të përfshijë organizata joqeveritare, ekspertë të pavarur, me synim forcimin e besimit të qytetarëve në sistemin politik.

Lidhur me konfliktin e interesave në nivelet e larta të qeverisjes ekspertët sugjeruan përcaktimin e rregullave më të qarta për anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe këshilltarët politikë. Po ashtu ata shprehën disa mendime lidhur me kufizimin e tyre pas përfundimit të funksionit, për sektorin ku mund të punësohen dhe periudhën e ndalimit, për parashikimin e mekanizmave të përshtatshëm për garantimin e zbatimit efektiv të Kodit Ministror të Etikës, forcimin e pavarësisë së Komisionit të Etikës, përcaktimin për herë të parë të rregullave dhe shqyrtimin e imtësishëm të punësimit në sektorin publik të drejtuesve dhe aksionerëve të shoqërive tregtare që marrin poste publike.

Për sa i përket deklarimit dhe verifikimit të pasurive, që është kompetencë funksionale e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ekspertët vlerësuan se duhet një përqendrim më i madh në identifikimin e parregullsive dhe zbatimin e sanksioneve kur ka mosdeklarime ose deklarime të rreme, çka do të përmirësonte transparencën dhe do të ndihmonte në mbrojtjen e integritetit të institucioneve publike etj.

Lidhur me financimin dhe transparencën e fushatave elektorale të partive politike ekspertët identifikuan disa mekanizma për forcimin e Kodit Zgjedhor dhe të ligjit “Për partitë politike”. Rekomandimet e ekspertëve për ndërhyrje konsistojnë në: përcaktimin e qartë në ligj se cilët do të konsiderohen “palë të treta”; përcaktimin e rregullave që parandalojnë abuzimet nga burime të fshehta financimi; detyrimin ligjor të partive politike për publikimin e të gjitha informacioneve mbi burimet e financimit dhe shpenzimet e tyre; rishikimin e mënyrës se si bëhet auditimi i financave të partive politike; përcaktimin e kufizimeve specifike në Kodin Zgjedhor për vetëfinancimin e kandidatëve, për donatorët individualë dhe entitete të tjera; përcaktimin në mënyrë të qartë nëse ulja e çmimit të reklamave apo mbulimi mediatik i padeklaruar i partive politike dhe kandidatëve do të konsiderohet “dhënie fondesh”; përcaktimin e rregullave specifike për financimin digjital të fushatave për të siguruar transparencë dhe kontroll të rregulluar të shpenzimeve në hapësirën online; përcaktimin e rregullave të qarta për përfitimet jofinanciare, si shërbimet mediatike, që mund të ndikojnë në politikën gjatë fushatave; raportimin e burimeve të financimit nga palët e treta, përfshirë organizatat joqeveritare dhe individët që nuk janë kandidatë, por përfshihen në fushata.

Lidhur me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit transnacional të zyrtarëve të lartë dhe të zgjedhurve ekspertët vlerësuan se legjislacioni aktual është pjesërisht i përafuar me konventën “Për luftën kundër korrupsionit të zyrtarëve të huaj publikë në transaksionet ndërkombëtare të biznesit”, por ka ende hapësira të rëndësishme për përmirësim. Ekspertët sugjeruan krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve për forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, miratimin e projektligjit për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve, i cili do të ndihmojë në rikuperimin e asetëve të fituara nga korrupsioni dhe të transferuara jashtë vendit; forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zbatimin e masave për gjurmimin, ngrirjen dhe konfiskimin e asetëve; përshpejtimin e ratifikimit të konventës “Për luftën kundër korrupsionit të zyrtarëve të huaj publikë...”, e cila vendos standarde ligjore detyruese për kriminalizimin e rryshfetit ndaj zyrtarëve të huaj në transaksionet ndërkombëtare të biznesit.

Lidhur me mekanizmat për parandalimin dhe kontrollin e korrupsionit në procesin legjislativ ekspertët evidentuan disa çështje që kanë nevojë për t’u trajtuar, si: individët me lidhje me partitë politike nuk duhet të konsiderohen për pozita drejtuese në institucionet e pavarura; forcimi i transparencës përmes vendosjes së detyrimit për publikimin e programit të punës së qeverisë; Kuvendi duhet të ndërmarrë nismën për krijimin e një organi të specializuar ose t’ia delegojë këtë funksion një organi ekzistues, i cili do të jetë përgjegjës për kontrollin paraprak të korrupsionit në projektaktet ligjore.



15 nëntor 2024

## Tryeza me temë “Parandalimi i pastrimit të parave dhe korrupsionit transnacional”, organizuar në kuadër të shtyllës së antikorrupsionit

Në këtë tryezë, e cila u moderua nga znj. Nirvana Deliu, eksperte në organizatën e pavarur Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA), u diskutuan gjetjet e ekspertëve mbi situatën aktuale, arritjet dhe problematikat e evidentuara lidhur me masat për parandalimin e financimeve të paligjshme dhe pastrimit të parave, si dhe çështjet që ata mendojnë se kanë nevojë për ndërhyrje. Gjetjet kryesore në këtë fushë dhe masat e karakterit ligjor dhe institucional të lidhura ngushtësisht me luftën kundër formave të tjera të kriminalitetit, që gjenerojnë të ardhura të jashtëligjshme brenda apo jashtë vendit, si: krimi i organizuar, korrupsioni, evazioni fiskal, i prezantoi prof. asoc. dr. Skerdian Kurti, pedagog në Fakultetin e Drejtësisë, dhe prof. asoc. dr. Ledion Shahini, pedagog në Fakultetin e Ekonomisë.

Sipas ekspertëve, pavarësisht progresit që ka bërë Shqipëria në përmirësimin e kuadrit ligjor kundër pastrimit të parave, çka është konfirmuar nga institucionet ndërkombëtare dhe raporti i MONEYVAL, i FATF-së, raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë, Screening, 2023 etj., ka ende nevojë që legjislacioni shqiptar të harmonizohet plotësisht me legjislacionin e BE-së. Nga analiza rezulton: pastrimi i parave vijon të mbetet një ndër krimet më të përhapura te grupet kriminale; ka një rritje të përdorimit të shoqërive tregtare, veçanërisht në pasuritë e paluajtshme, të cilat shërbejnë për të marrë dhe transferuar paratë e fituara nëpërmjet veprimtarive kriminale; institucionet ligjzbatuese kanë ende nevojë të forcojnë kapacitetet e tyre për të bërë hetime financiare komplekse paralelisht me hetimet penale etj.

Ekspertët parashtruan disa çështje që kanë nevojë për t'u adresuar, si: identifikimi i rasteve të pastrimit të parave nëpërmjet deklarimeve të tatim-taksave dhe zbatimit të sekuestrimeve dhe konfiskimeve për rastet e kryerjes së veprave penale në lidhje me to; efektiviteti i kontrollit të të dhënave doganore, veçanërisht për kompanitë që bëjnë import-eksport, transportit të parave në dorë (*cash*), unifikimi i gjobave me vendet e tjera si dhe parashikimi në Kodin Penal i rasteve të mosdeklarimit të parasë *cash* për të përcaktuar dallimin e mosdeklarimit të shoqëruar me dokumente bankare ose forma të tjera vërtetësie nga rasti kur paratë janë fshehur për qëllim mosdeklarimi; adresimi i numrit të ulët apo mungesës së hetimeve financiare paralele me hetimin e veprave penale për shkelje ligji që gjenerojnë produkte/të ardhura kriminale; funksionimi sa më praktik dhe gjithëpërfshirës i Regjistrit të Pronarëve Përfitues si dhe ulja në nivelin 25% të aksioneve për bërjen publik të pronarëve; zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore dhe qëndrueshmëria e tyre në detyrë, me fokus çështjet e pastrimit të parave dhe aseteve të sekuestruara.

12 nëntor 2024

## Tryeza me temë “Procesi i rregullt ligjor dhe edukimi ligjor i publikut”, organizuar në kuadër të shtyllës së sundimit të ligjit

Kjo tryezë u moderua nga znj. Ina Xhepa, drejtore ekzekutive e Qendrës për Zhvillim dhe Integrim Europian (CEDI), e cila bëri dhe një prezantim të gjetjeve të grupit të ekspertëve lidhur me sfidat dhe problematikat që hasen në mbrojtjen, respektimin dhe mekanizmat garantues të së drejtës për një proces të rregullt ligjor të qytetarëve.

Sipas ekspertëve, harta e re gjyqësore ka krijuar sfida të mëdha për garantimin e procesit të rregullt, pasi ulja e numrit të gjykatave nuk duhet të pengojë qasjen e qytetarëve në drejtësi, ndërkohë që mungon edhe një plan i detajuar i shmangies së risqeve të ardhura nga zbatimi i hartës së re gjyqësore.

Disa prej problemeve të evidentuara nga ekspertët janë: kohëzgjatja e proceseve, çka vjen nga vakancat në sistemin e drejtësisë; mbingarkesa e gjykatave, që cenon afatin e arsyeshëm; afatet e arsyetimit të vendimeve për masat e sigurimit; mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, përfshirë edhe ato të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut; ndihma juridike falas, për të cilën duhet një qasje më e ndjeshme ndaj gjinive; mungesa e prodhimit të statistikave gjyqësore; trajtimi i masave të paraburgimit dhe problematikat lidhur me respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë.

Për eliminimin e problemeve të mësipërme ekspertët sugjerojnë rishikimin e kuadrit ligjor në fushën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për t'iu përgjigjur boshllëqeve dhe paqartësive që pengojnë ekzekutimin e drejtë dhe në kohë; krijimin e një sistemi efikas për mbështetjen me burime njerëzore dhe monitorimin e shërbimit përmbartimor shtetëror dhe privat dhe mbikëqyrjen e procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore; krijimin e një platforme *on-line* ku qytetarët dhe palët e tjera të interesuara mund të ndjekin ecurinë e vendimeve, që do të ndihmonte në përmirësimin e transparencës dhe rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë; krijimin e një mekanizmi të posaçëm për monitorimin dhe zbatimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Në panelin e dytë të tryezës, në të cilin u diskutua për edukimin ligjor të publikut, gjetjet kryesore të analizës së ekspertëve u prezantuan nga prof. asoc. dr. Nadia Rusi, pedagogje në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, e cila parashtroi një përmbledhje të gjetjeve mbi problematikat dhe sfidat kryesore që pengojnë arritjen e plotë të objektivave të edukimit ligjor, i cili mundëson një presion pozitiv nga ana e qytetarëve për zbatimin në praktikë të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të tyre nga institucionet publike, çka ndikon në rritjen e llogaridhënies dhe forcimin e shtetit të së drejtës.

Disa nga sfidat kryesore të konstatuara nga ekspertët janë:

- mungesa e koordinimit dhe institucionalizimit të edukimit ligjor të publikut dhe mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore;
- mospasja e një kornize ligjore për të përcaktuar qartë detyrimet dhe përgjegjësitë e çdo institucioni dhe aktori të përfshirë në këtë proces;
- mungesa e informacionit të qartë dhe të thjeshtë për qytetarët për secilën prej të drejtave;
- mungesa e ndërgjegjësimit publik për edukimin ligjor;
- pabarazia në qasje, pasi edukimi ligjor shpesh është i përqëndruar në zonat urbane;
- barriera gjuhësore dhe kulturore për grupet vulnerabël;
- kufizimet e infrastrukturës digjitale dhe teknologjike;
- mungesa e përshtatjes së programeve të edukimit ligjor për personat me aftësi të kufizuara në shikim e dëgjim;
- fragmentimi i programeve dhe projekteve të edukimit ligjor të publikut.

Ekspertët sugjeruan nevojën për rritjen e ndërgjegjësimit për t'iu qasur edukimit/informacionit ligjor; krijimin e infrastrukturës së përshtatshme, e cila shmang barrierat gjeografike dhe gjuhësore, veçanërisht për grupet vulnerabël; krijimin e programeve të përbashkëta dhe të koordinuara të edukimit ligjor nga të gjithë aktorët si dhe zgjerimin e hartës së ofrimit të edukimit ligjor të publikut.

13 nëntor 2024

## **Tryeza me temë “Funksioni ligjvënës dhe forcimi i rolit të Kuvendit për zbatimin e ligjeve si dhe efektiviteti, transparencja dhe llogaridhënia e vetë Kuvendit”, organizuar në kuadër të shtyllës së sundimit të ligjit**

Diskutimet e tryezës u zhvilluan nën moderimin e prof. asoc. dr. Juelda Lamçe, dekane e Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Universiteti Europian i Tiranës, e cila së bashku me prof. dr. Aurela Anastasi, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, prezantuan gjetjet dhe sugjerimet e ekspertëve për rolin ligjvënës të Kuvendit si dhe efektivitetin, transparencën dhe llogaridhënien e vetë Kuvendit në kuadër të reformimit dhe forcimit të rolit të tij në procesin e integritetit në Bashkimin Europian.

***Për funksionin ligjvënës dhe forcimin e rolit të Kuvendit në zbatimin e ligjeve*** ekspertët propozuan si hapa pozitivë rritjen e transparencës, shtimin e akteve që i nënshtrohen konsultimit publik nëpërmjet platformës përkatëse digjitale dhe veprimtarinë e Kuvendit për kontrollin postlegjislativ. Duke mbajtur në konsideratë rekomandimet e raporteve të Komisionit Europian për Shqipërinë, masat në planin përkatës të Kuvendit për zbatimin e tyre si dhe raportet e organizatave ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile në këtë drejtim ekspertët

prezantuan gjetjet lidhur me rolin ligjvënës të Kuvendit. Disa prej gjetjeve janë:

- nuk ka një mekanizëm apo një metodologji standarde si adresohen komentet që vijnë nga konsultimi publik i akteve;
- raportet e Kuvendit fokusohen më shumë në të dhëna statistikore, pa dhënë shpjegime se çfarë është arritur nga konsultimi publik;
- ka mangësi në mekanizmat efektivë që parandalojnë korrupsionin legjislativ;
- edhe pse janë bërë përpjekje të vazhdueshme, sistemi *e-legislation* nuk është vënë ende në zbatim;
- nuk ka një metodologji standarde për zbatim në kontrollin postlegjislativ, edhe pse së fundi janë bërë hapa përpara me miratimin e një vendimi nga Konferenca e Kryetarëve dhe disa komisione kanë nisur të bëjnë këtë lloj kontrolli;
- burimet njerëzore të Kuvendit nuk kanë njohuri të posaçme për kontrollin postlegjislativ;
- nismat ligjvënëse të zgjedhësve janë në nivele shumë të ulëta;
- raportet e takimeve me grupet e interesit sipas parashikimeve në Kodin e Sjelljes që publikohen janë të rralla dhe nuk tregojnë çfarë rezultatesh sjellin në ligjbërje.

Ekspertët ndër të tjera sugjeruan rishikimin e Rregullores së Kuvendit për ta plotësuar me rregulla të qarta për kontrollin postlegjislativ (3 deri në 5 vjet pas miratimit të ligjeve) jo vetëm për aktet që kanë përafrim me legjislacionin e Bashkimit Europian, por edhe për ligjet e tjera; përfshirjen në Rregulloren e Kuvendit dhe në Kodin e Sjelljes të mekanizmave që parandalojnë korrupsionin legjislativ; amendimin e manualit përkatës të konsultimit publik, duke parashikuar metodologjinë e shqyrtimit të mendimeve që vijnë nga shoqëria civile, grupet e interesit, qytetarët etj., si dhe rregulla për dëgjesa me propozuesit në mbledhjet e komisioneve parlamentare; përmirësimin e platformës *on-line* të konsultimit publik dhe shtimin e kohës në dispozicion, duke hequr dhe barrën joproporcionale për publikun që sugjerimet të vijnë sipas teknikës legjislative, pasi dekurajon përfshirjen e publikut në vendimmarrje; plotësime në Rregullore për të drejtën e peticionit dhe aplikimin *e-peticion*.

Në lidhje me cilësinë e legjislacionit ekspertët sugjeruan krijimin e një mekanizmi efektiv dhe të specializuar për filtrimin e formulimeve apo dispozitave që mund të mos e kalojnë testin e kushtetutshmërisë që në shqyrtimin në komisionet parlamentare, por edhe për amendamentet që paraqiten në seancë; forcimin dhe/ose riorganizimin e strukturave të brendshme të Kuvendit të specializuara për të siguruar pajtueshmërinë e projektligjeve me Kushtetutën dhe kuadrin ligjor në fuqi. Ata sugjeruan fuqizimin e kapaciteteve të Kuvendit edhe për të shtuar përdorimin e të dhënave dhe analizave statistikore e cilësorë për të rritur qasjen e politikëbërjes bazuar në evidencë, për të ushtruar me efektivitet kontrollin postlegjislativ dhe për të kryer testet e përputhshmërisë me qasjen gjinore dhe mosdiskriminuese të akteve. Përmirësimet në Kodin e Etikës sugjerohen në drejtim të raportimit dhe transparencës së aktiviteteve lobuese që kanë ndikim në procesin legjislativ (vënien në zbatim të *e-legislation* për të rritur transparencën dhe efektivitetin e Kuvendit etj.).

***Në lidhje me efektivitetin, transparencën dhe llogaridhënien e Kuvendit***, sipas ekspertëve, referuar anketës “Besimi në qeverisje” (2023), Kuvendi është një ndër tre mekanizmat, së bashku me Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH) dhe medien, e perceptuar si më efektivët për llogaridhënien. Kuvendi ka përmirësuar mekanizmat e transparencës dhe të llogaridhënies parlamentare nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja dhe digjitalizimit të dokumenteve. Raportet e BE-së kanë njohur rolin aktiv të Kuvendit në miratimin e ligjeve që përputhen me standardet europiane, si ato që synojnë rritjen e pavarësisë së gjyqësorit, luftën kundër korrupsionit dhe forcimin e institucioneve të zbatimit të ligjit. Një hap pozitiv përpara konsiderohet miratimi i Kodit të Sjelljes.

Ndër gjetjet kryesore që evidentuan ekspertët janë:

- nevoja për rritjen e kapaciteteve të komisioneve parlamentare për më shumë eficiencë;
- publikimi me vonesë dhe përditësimi i dokumenteve dhe botimeve parlamentare për shkak të mbingarkesës së punës (procesverbalet, raportet periodike dhe vjetore);
- nuk ka njësim të statistikave në disa kategori të publikimeve të Kuvendit dhe se shifrat pa informacion shoqërues nuk ofrojnë informacion cilësor dhe shterues;
- sistemi i publikimit të transkriptimeve nuk ka vlerësime periodike për të kuptuar perceptimin e publikut për institucionet dhe marrëdhëniet e Kuvendit me institucionet e pavarura;
- ka nevojë për më shumë gjithëpërfshirje në buxhetimin e institucionit, sfidat e zbatimit të Kodit të Sjelljes në drejtim të transparencës dhe llogaridhënies së veprimtarisë së deputetit.

Për rritjen e kapaciteteve të komisioneve parlamentare ekspertët sugjeruan rritjen e numrit të komisioneve të përhershme parlamentare, duke i rindarë në më shumë grupe (me më pak anëtarë), në përputhje me qasjen krahasuese me vendet e BE-së. Ekspertët sugjeruan gjithashtu krijimin e komisioneve të posaçme për monitorimin e realizimit të reformave; rritjen e kapaciteteve profesionale të stafeve; digjitalizimin e procesit të transkriptimit të veprimtarisë parlamentare dhe botimin në kohë të procesverbaleve dhe raporteve për të rritur transparencën dhe për të lehtësuar proceset voluminoze të punës; krijimi i një biblioteke digjitale të akteve; zhvillimin e një sistemi efektiv të llogaridhënies për deputetët, që përfshin rregulla të detajuara mbi kontaktet me lobistët dhe palë të tjera të treta dhe të sigurohet transparencë e mjaftueshme për qëllimin e këtyre kontakteve; publikimi i raporteve financiare dhe të auditimit të buxhetit të Kuvendit etj.

Gjatë diskutimeve në këtë tryezë pati sugjerime të vlefshme nga të pranishmit, disa prej të cilave janë: ulja e numrit të firmëtarëve për nismat ligjvënëse të zgjedhësve; zgjatja e afateve në dispozicion për konsultimin publik; nevoja për të mundësuar qasje të grupeve të interesit në të gjithë Shqipërinë, pasi në regjistrin e konsultimit publik pjesa më e madhe e subjekteve rezultojnë me seli në Tiranë; nevoja për një qasje të integruar në zbatimin e rekomandimeve që jepen për Kuvendin për të evituar segmentimin e punës dhe mbivendosjet; reformimi i proceseve parlamentare sipas kërkesave që rrjedhin nga procesi

integrues me Bashkimin European dhe rikonceptimi i procesit ligjbërës në këtë këndvështrim; nisma për një ligj të posaçëm për funksionimin e Kuvendit të Shqipërisë etj.

15 nëntor 2024

## **Tryeza me temë “Forcimi i rolit mbikëqyrës, koordinues dhe monitorues të Kuvendit duke respektuar parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve si dhe përmirësimi i funksionit zgjedhës të Kuvendit duke respektuar parimin e meritokracisë, të transparencës dhe paanshmërisë”, organizuar në kuadër të shtyllës sundimi i ligjit**

Në këtë tryezë, e cila u moderua nga dr. Emilio Çika, pedagog në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, z. Gledis Gjipali, drejtor ekzekutiv i Lëvizjes Europiane në Shqipëri, prezantoi gjetjet kryesore të analizës së ekspertëve, të cilët vlerësojnë se kuadri ligjor për funksionimin e institucioneve të pavarura në Shqipëri përputhet me standardet ndërkombëtare, të njohura si “Parimet e Parisit”. Vendi ynë ka përparime të rëndësishme në forcimin e institucioneve të saj të pavarura, megjithatë duhet përmirësuar efienca dhe transparenca e tyre si dhe zbatimi i plotë i rekomandimeve të Kuvendit.

Sipas ekspertëve, një sërë problematikash që lidhen me shqyrtimin e raporteve vjetore të institucioneve të pavarura nga Kuvendi dhe komisionet parlamentare, duke zbatuar afatet ligjore dhe procedurat e raportimit; zhvillimin e takimeve periodike midis Kuvendit, institucioneve të pavarura dhe qeverisë për përditësimin e platformës ndërinstitucionale *on-line* për rekomandimet e institucioneve të pavarura; zbatimin e Mekanizmit Ndërinstitucional Kuvend-qeveri-institucione të pavarura për monitorimin sistematik të rekomandimeve; rikonfigurimin dhe zgjerimin e platformës ndërinstitucionale *on-line*; shtimin e dëgjësive, veçanërisht kur ka rekomandime të pazbatuara; përfshirjen e shoqërisë civile dhe të medias në monitorimin e zbatimit të rekomandimeve; vlerësimin e performancës përmes buxhetimit me rezultate në atë masë sa nuk prek cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike dhe mbrojtjes së interesit publik etj

Ekspertët vlerësuan se Kuvendi ka krijuar një sistem gjithëpërfshirës për monitorimin e ligjeve, veçanërisht atyre që lidhen me legjislacionin e Bashkimit European, megjithatë nevojiten përmirësime në lidhje me formalizimin e kriterëve të monitorimit, kohën e zbatimit të monitorimit; përmirësimi i kapaciteteve të brendshme, garantimi i mbështetjes profesionale si dhe përfshirja e ekspertëve të pavarur. Në analizën e tyre ekspertët theksuan se rritja e bashkëpunimit midis Kuvendit dhe qeverisë si dhe shmangia e politizimit të proceseve parlamentare janë të nevojshme për një monitorim më efektiv.

Një komponent thelbësor i evidentuar nga ekspertët është kontrolli postlegjislativ. Sipas tyre, sfidat me të cilat përballlet ky proces, përveç të tjerave, janë vonesat në dorëzimin e raporteve dhe mungesa e kriterëve të qarta për

përzgjedhjen e ligjeve që do të kontrollohen. Për zgjidhjen e këtyre problemeve ekspertët sugjeruan forcimin e kapaciteteve të shërbimeve, përcaktimin e kriterëve të qarta për përzgjedhjen e ligjeve që i nënshtrohet kontrollit postlegjislativ dhe përfshirjen e grupeve të interesit në proces.

Për zgjedhjen e drejtuesve të institucioneve të pavarura ekspertët sugjeruan se duhet siguruar transparencë në procesin e nominimeve, përfshirë konsultimet publike dhe debatin e hapur. Sipas tyre, duhet të forcohen kriteri i meritokracisë dhe i integritetit dhe në këtë drejtim mund të shihet mundësia për një verifikim më të plotë të kandidatëve.

Ekspertët sugjeruan krijimin e komisioneve të pavarura të përzgjedhjes paraprake për emërimin e drejtuesve të institucioneve të pavarura, parashikimin në legjislacion të mekanizmave zhblokues për të shmangur bllokimet politike në procesin e emërimit.

## **Çfarë pritet të ndodhë gjatë muajit dhjetor me agjendën e Komisionit?**

Me qëllim përmbushjen e parimeve kryesore mbi të cilat është ndërtuar puna e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit dhe gjithë procesi reformues që synon të realizojë ky Komision, gjatë muajit dhjetor 2024, nën drejtimin e ekspertëve të nivelit të lartë do të zhvillohen edhe 2 tryeza tematike publike, si dhe do të punohet për organizimin e forumeve të dialogut qytetar, me fokus çështjet e ndjeshme për qytetarët.

Në të njëjtën kohë do të vijojë procesi i konsultimeve me grupet e interesit, përfshirë institucionet shtetërore dhe agjencitë ekzekutive ligjzbatuese, si dhe ekspertë e konsulentë ndërkombëtarë, çka do të bëjë të mundur tërheqjen e mendimeve dhe finalizimin e Dokumentit Analitik/Analizës.

Gjatë muajit dhjetor do të organizohen edhe forumet e dialogut qytetar, me fokus një sërë çështjesh të ndjeshme për qytetarët, përfshirë ato që lidhen me nevojën për një qeverisje vendore më të mirë, çështjet që lidhen me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit etj. Forumet do të zhvillohen kryesisht në nivel vendor dhe në qendrat universitare si bashkëbisedim me pedagogët dhe studentët.

Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, në konsultim me ekspertë të huaj, do të nisë punën për hartimin e Plani Kombëtar të Veprimit, ku do të përcaktohen masat konkrete legjislative e institucionale për ndërhyrje jo thjesht në legjislacion, por në procesin e zbatimit të ligjit.

Komisioni i Posaçëm do të zhvillojë mbledhjet e tij të zakonshme periodike, të cilat do të fokusohen në aspektet organizative të procesit.

### **Komisioni i Posaçëm Parlamentar**



## **KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR**

**“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,  
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN PËR  
SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**